



103

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKENr. 9862 prot.Vlorë, më 20.05.2026

## PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_.2026

PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË  
BANESAVE SHTETËRORE TË PAPERIVATIZUARA

Këshilli i Bashkisë, në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » të ndryshuar, neni 77/1,a, të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ;

## V E N D O S I

1. Të miratojë privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara për qytetarët me të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.
2. Të miratojë vlerën e apartamentit, që do të privatizojnë këta qytetarë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.banese	Struktura	Sipërfaqja/ m2	Vlera apartam. (lekë)	Vl.truallit lekë	Vl.plotë ( lekë)
1	Vladimir	Kapo	Llanaj (Trashëgimtarët)	1319	1+1	58,5	9500	113853	123353
2	Zenepe	Fejzo	Kapaj (Trashëgimtarët)	507	1dhomë + 1 korridor	36	0	259492	259492

**KRYETAR**

**Brunilda Mersini**

**ME URDHËR DELEGIMI**

**NËNKRYETAR**

**Joljana Llanaj**

